

PORTRET PËR PENSIONISTIN AJET QAMILI

# PENSIONISTI I MISHËRUAR ME AKTIVITETET E ORGANIZIMIT PENSIONAL

Të gjithë angazhimin e tij në punë, Qamili e ka kaluar në shkollën e fshatit Shemshovë, duke i shërbyer institucionit më shumë se 40 vjet. Në këtë çerdhe të arsimit dhe edukimit ai ka punuar si punëtor teknik, duke e mirëmbajtur gjithë objektin në aspektin e montimit të pjesëve të ndryshme dhe riparimit të mësonjëtorëve dhe angazhime të tjera, duke kontribuar në mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor



Ajet Qamili. Sipas tij, në fshatrat e sipërpërmendura jetojnë pensionistë të dy nacionaliteteve, por përkatësia kombëtare pothuaj nuk është vërejtur asnjëherë. Kemi punuar bashkërisht, duke u përqendruar t'i mbështesim ata pensionistë që kanë pensione të ulta apo ballafaqohen me probleme të natyrës sociale. Sipas Qamilit, ndihmat në para, që i janë caktuar secilës degë, janë ndarë në mënyrë të drejtë, duke i ndihmuar ata që vërtetë kanë pasur nevojë për mbështetje financiare apo ndonjë lloj tjetër të ndihmës.

Të gjithë angazhimin e tij në punë, Qamili e ka kaluar në shkollën e fshatit Shemshovë, duke i shërbyer institucionit më shumë se 40 vjet. Në këtë çerdhe të arsimit dhe edukimit ai ka punuar si punëtor teknik, duke e mirëmbajtur gjithë objektin në aspektin e montimit të pjesëve të ndryshme dhe riparimit të mësonjëtorëve dhe angazhime të tjera, duke kontribuar në mbarëvajtjen e procesit edukativo-arsimor.

Ajet Qamili nënvizon se edhe gjatë organizimit të ekskursioneve, jemi kujdesur që këtë mundësi ta shfrytëzojmë të gjithë pensionistët e interesuar, ndërsa gjithmonë përparësinë e kanë pasur ata të cilët nuk e kanë shfrytëzuar si dhe ata të cilët, për shkak të hyrave të ulta e kanë pasur të pamundur të udhëtojnë në destinacione të ndryshme. Pensionisti 91 vjeçar, edhe në këtë moshë, gëzon shëndet të plotë, është aktiv, ndërsa një pjesë të konsiderueshme të kohës e kalon bashkë me shumë nipër e mbesa, të cilët jetojnë, punojnë e shkollohen në Tetovë, në Shemshovë dhe në Danimarkë. (M. Murseli)

Ajet Qamili, i lindur në vitin 1933 në fshatin Shemshovë të komunës së Zhelinës, pjesën më të madhe të jetës si pensionistë ia ka kushtuar organizimit dhe realizimit të aktiviteteve të moshave të treta. Qamili, që nga pensionimi i tij, ka marrë përsipër të përfshihet në organizimin pensional, në degën e Shemshovës, ku si kryetar i degës vendore ka shërbyer plot 24 vjet. Edhe sot, për shkak të moshës së shtyrë, është tërhequr nga disa aktivitete, prapëseprapë, me punën e tij u jep mbështetje të pakursyer dhe udhëzime në punën e tyre, strukturave të reja udhëheqëse të degës së pensionistëve të Shemshovës. Edhe pse banon me familjen e tij në Tetovë, në fshatin e lindjes ka shtëpinë dhe pronën përreth saj, për të cilën kujdeset në vazhdimësi nga muaji prill e deri në fund të tetorit.

Ajet Qamili, tash më 91 vjeçar,

edhe sot e kësaj dite, shpesh e viziton selinë e Shoqatës së pensionistëve në Tetovë, për të shkëmbyer mendime me udhëheqësinë e saj dhe pensionistë të shumtë, mbi aktivitetet që zhvillohen dhe sfidat e organizimit të pensionistëve. Para ca ditësh, pensionistin Qamili e takuam tek klubi pensionistëve në Tetovë duke e shfrytëzuar mundësinë për të biseduar më të për shumça lidhet me moshat e treta.

-Si pensionistë, degës së Shemshovës i kam shërbyer plotë 24 vjet. Gjatë asaj periudhe, shpesh jemi tubuar pensionistë të fshatrave Shemshovë, Prelubishtë, Tudencë, Siririçinë e Zhillçë, për t'i diskutuar e trajtuar hallet e pensionistëve të këtij rajoni. Sa herë që kemi pasur njoftime nga Shoqata e Tetovës, për organizimin e mbledhjeve për të trajtuar problematika të shumta, jemi tubuar dhe kemi marrë qëndrime meritore, vlerëson

SHP TETOVË

## Karroca për pensionistët me aftësi të kufizuara

I njohur për aksionet e tij humanitare, Safet Alili nga fshati Prisojnicë, i cili ka emigruar në Luksemburg shumë vite më parë, vazhdon me aksionet e tij humanitare në mbarë Maqedoninë e Veriut. Alili përmes organizatës humanitare "Letzcare", në Luksemburg, ku jeton me familjen e tij, dhe në vitet e fundit ka ofruar ndihma të shumta për nevojat e institucioneve këtu.

"Ndihma nuk është kurrë e mjaftueshme. Ne vazhdojmë të dhurojmë nën moton 'ndani pasurinë tuaj materiale me të tjerët, me ata që kanë nevojë'. Fillimi ishte i vështirë, por tani gjërat janë bërë më të thjeshta. Që nga projekti i parë i kemi dhuruar pajisje ndihmëse, aparatura për shtëpinë e shëndetit në Rostushë si dhe për institutin për sëmundje të mushkërive në Oteshevë", u shpreh ai.

Humanisti Safet Alili pak ditë më parë ka dhënë një donacion për SHP



Tetovë i përbërë nga një numër i madh karrocash dhe mjete lëvizëse për pensionistët me aftësi të kufizuara. Kryetari i SHP Tetovë, Selver Memeti, e falënderoi për donacionin, me të cilin u pajtuan që bashkëpunimi i ndërsjellë do të vazhdojë edhe në të ardhmen

dhe do të intensifikohet, me qëllim që të arrihen efekte më të mëdha humanitare në ndihmë të personave me nevojë të veçanta. Do të ishte mirë dhe e dobishme sikur të kishte edhe njëqind shembuj të tillë humanitarësh, njerëz që japin mirësi. (M.M)

PEHÇEVË



## Në vatrën e babait

Së fundmi në Pehçevë pata një takim interesant me djalë të ish-bashkatdhetarit tonë, banor në Izmir të Republikës së Turqisë, pensionistin Kadri Dogu, i cili i rrëmbyer nga kujtimet familjare, bleu shtëpinë e vjetër familjare të tezes afër shtëpisë së rrënuar të babait dhe afër saj nisi të ndërtonte një të re. Distanca prej rreth 1100 kilometrash, sipas tij, nuk është problem për të dhe me kënaqësi ka folur për planet e tij për të ardhmen. Kadri Dogu ka lindur në Izmir në vitin 1960. Shkollën fillore dhe të mesme i kreu në vendlindje, më pas u diplomua në Fakultetin e Edukatës fizike – EGE dhe u punësua në shkollë të mesme si mësues deri në vitin 2016, kur doli në pension. Paralelisht me punën e tij në shkollë ndjek kurse dhe është mësues noti dhe shpëtimtar në ujë. Ai ka një djalë që studion për ekonomi në Strasburg të Francës, i cili është një mbështetje e madhe për të gjitha aktivitetet në Pehçevë.

"Në Pehçevë kam ardhur për herë të parë në vitin 1986/1987 për të vizituar tezen time dhe të afërmit. Kisha dëshirë të studioja në Sarajevë, por nuk ia dola dhe që atëherë nisim vizitat e mia të shpeshta në Pehçevë. Unë kam një synim për të përfunduar shtëpinë, për të cilën kam mbështetjen e familjes. Shtëpinë e ndërtoj vetë me ndihmën e miqve dhe dua të jetoj këtu, sepse këtu janë rrënjët e mia. Kam në plan të prish shtëpinë e vjetër dhe të ndërtoj dy garazhe dhe një terracë në atë vend. Të parët e mi kanë ardhur nga Pehçeva nga familjet Axhime-medovi dhe Gjurovski dhe janë varrosur në varrezat myslimane në Pehçevë. Kam gjetur varrin e gjyshit tim. Babai im Sulejmani ishte një marangoz i famshëm në qytet. Fillimisht punoi privatisht, e më pas për pesëmbëdhjetë vjet punoi në Ekonominë e pyjeve në Pehçevë deri në largimin e tij në Turqi në vitin 1957. Unë kam një vëlla më të madh të lindur në Pehçevë, i cili është ortoped i njohur në Izmir dhe dy motra pensioniste. Edhe xhaxhai im Riza ishte marangoz i njohur në Pehçevë", i shpreh Kadriu.

Krahas rrënjëve, Kadriu me kënaqësi flet edhe për shoqërimin e "kombëtarëve" në Izmir, për festimet e përbashkëta ku luhen vetëm këngë maqedonase dhe luhen valle maqedonase, si dhe dëshirën e të gjithëve për kontakte më të shpeshta përmes pjesëmarrjes në festime të ndryshme, festa dhe nderime duke u shoqëruar dhe në raste të tjera. Bashkëbiseduesi im më tha se ka aplikuar për shtetësi maqedonase dhe së shpejti pret përgjigje pozitive në mënyrë që t'i rregullojë dokumentet e udhëtimit dhe të mos ketë kufizime gjatë qëndrimit në Pehçevë.

Ndryshe, Kadriu është i kënaqur me qëndrimin e pehçevaseve të cilët e kanë pranuar për të tyrin dhe janë gjithmonë të gatshëm për bisedë dhe ndihmë të mundshme për ndërtimin e shtëpisë. Se sa e do atdheun e prindërve e dëshmon edhe fakti se për një kohë të shkurtër ka arritur të mësojë të flasë rrjedhshëm gjuhën maqedonase, në mënyrë që të mos ketë pengesa gjatë komunikimit me bashkëqytetarët e tij në Pehçevë. Së bashku me të kemi pasur një takim edhe me kryetarin e Komunës së Pehçevës, Aleksandar Kitanski, me të cilin Kadri Dogu ka biseduar për idenë e sjelljes së grupeve të këndimit nga Izmiri në Festivalin e Tunxheve, i cili mbahet çdo verë në Pehçevë., si dhe ideja për të animuar bashkëqytetarët e tij me origjinë nga Maleshevia për të investuar në Pehçevë përmes blerjes dhe mbarështimit të deleve dhe ide të tjera. Kryetari i komunës shprehu gatishmërinë për të ndihmuar në kuadër të kompetencave të tij dhe gatishmërinë e tij në kohën e duhur që një delegacion nga Komuna e Pehçevës ta vizitojë Komunën e Izmirit ku do të merren vesh për hapat dhe aktivitetet e ardhshme. (A. Kacarski)